

## Pandemia: Disa Syzime Semiotike

*Received: 23.06.2024 / Accepted: 13.07.2024 / Published: 10.03.2025*

© 2024 Brikena Smajli

### Abstrakt:

Në periudhën që përfshin më shumë se dy vjet (mars 2020 - tetor 2022), qemë dëshmitarë të një transformimi të thellë në thelbin e jetës dhe ekzistencës sonë, shoqëruar nga një sërë masash kufizuese që riformuan kuptimin tonë themelor për njerëzimin. Këto ngjarje transformuese u pasqyruan me shpejtësi në evolucionin e gjuhës. Nga pikëpamja sociologjike, gjuha shërben si një regjistruar besnik i evolucionit shoqëror, duke i bërë jehonë trajektore të historisë njerëzore përmes luftërave, përparimeve shkencore, krizave, eksplorimeve dhe epidemive. Gjatë kohës së tronditjeve emocionale intensive dhe krizave ekzistenciale, gjuha i nënshtrohet një procesi ripërcaktimi, duke shënuar një riinterpretim të përkohshëm të fjalëve. Veçanërisht, metaforat e nxjerra nga lufta dhe alegoritë biblike kanë depërtuar në diskursin pandemik, duke nënvizuar ndikimin e thellë të këtyre ngjarjeve në peizazhin tonë gjuhësor (Fossali & Dondero, 2006).

Ky punim ndërmerr një analizë semiotike të shprehjeve dhe termave të zgjedhur, duke eksploruar rinovimin e tyre semantik si një mjet për të thelluar të kuptuarit tonë të fenomenit pandemik. Duke identifikuar dhe shqyrtuar këtë leksik në zhvillim nga një këndvështrim i ri, ne përqipemi të gjurmojmë konturet e mendimit të ngulitur brenda gjuhës. Siç artikulon me elokuencë Marco Senaldi në librin e tij "Pensare oltre", pandemia përfaqëson një moment të përshtatshëm për të sfiduar dhe riformuluar kornizat tona njohëse...

**Fjalë kyçe:** *pandemia, semantikë, maskë, analizë semiotike, shtëpi*

---

<sup>1</sup> Department of Communication Sciences, University College "Beder", Email: bsmajli@beder.edu.al

**Abstract:**

In the period spanning more than two years (March 2020 - October 2022), we witnessed a profound transformation in the essence of life and existence, accompanied by a series of restrictive measures that reshaped our fundamental understanding of humanity. These transformative events were swiftly mirrored in the evolution of language. From a sociological vantage point, language serves as a faithful recorder of societal evolution, echoing the trajectory of human history through wars, scientific breakthroughs, crises, explorations, and epidemics. During intense emotional upheaval and existential crisis, language undergoes a process of redefinition, marking a temporary reinterpretation of words. Notably, metaphors drawn from warfare and biblical allegories have permeated pandemic discourse, underscoring the profound impact of these events on our linguistic landscape (Fossali & Dondero, 2006).

This paper undertakes a semiotic analysis of select expressions and terms, exploring their semantic renewal to deepen our comprehension of the pandemic phenomenon. By identifying and scrutinizing this emerging lexicon from a fresh perspective, we endeavour to trace the contours of thought embedded within language. As Marco Senaldi eloquently articulates in his book "*Pensare oltre*", the pandemic represents an opportune moment to challenge and reformulate our cognitive frameworks...

**Keywords:** *pandemic, semantics, mask, semiotic analysis, home*

## Hyrje: shenjat, kuptimet

Në gjendjen në të cilën u detyrua të jetonte për rreth dy vite, e gjithë bota, e karakterizuar nga ndryshimi drastik i konceptit mbi jetën dhe të jetuarit dhe disa kufizimesh që shpërfaqtojnë të ekzistuarit, të sjellurit dhe të menduarit mbi njeriun, të përditshmen; ndodhën disa ndryshime domethënëse, të cilat u transmetuan edhe në gjuhë. Në pikëpamje sociologjike gjuha regjistron çdo ndryshim shoqëror. Njësoj siç ka ndodhur gjatë historisë së njerëzimit nga luftërat, zbulimet shkencore, krizat, eksplorimet, epidemitë, pikërisht kur emocionet e forta shtangin dhe trandin mendjen njerëzore, kur idetë e reja qarkullojnë të nxitura nga kjo ngjeshje dhe ky ngut ekzistencial, fjalë të huaja hyjnë në fondin e një gjuhe, të tjera të reja krijohen, shprehësi të tjera marrin formë, togëfjalësha të caktuar fitojnë një kuptim të ri të ngulitur; e gjithë kjo për të përshkruar saktë dhe vërtetësisht një formë mendimi dhe një mjet që na lejon të kategorizojmë përvojat njerëzore. Kështu, gjuha që përdorim, përfshi këtu edhe metaforat, ndikojnë në mënyrën tonë të menduarit dhe të perceptimit të ngjarjeve, duke luajtur një rol shumë domethënës në përcaktimin e asaj që është reale për ne (Lakoff & Johnson, 1980: 28, 61). Në këtë kuptim, motivohen edhe metafora e luftës dhe metaforat biblike që kemi ndeshur në ligjërimin për pandeminë. (Fossali & Dondero, 2006)

Në terma semiotikë, tashmë lipset të shohim përtej, duke përcaktuar e analizuar një leksik të ri të pandemisë; nëpërmjet këndvështrimit të ri, këndvështrimit pandemik, shtyhem të përkapim këtë kuptim të ri apo riaktivizimin e fjalëve të caktuara, të shohim lëvizjen e re gjuhësore dhe njëkohësisht, gjurmën e mendimit në gjuhë. Siç shkruan Marco Senaldi në librin e tij “*Pensare oltre*”, “*Pandemia është një mundësi për të ndryshuar mënyrë të menduari...*” (Senaldi, 2021:146) Në këtë punim të shkurtër do të ndalemi tek shembuj (shembullëzime) shenja nga biosemiotika, semiotika kulturore dhe ajo sociale. Megjithëse punimi si objekt studimi nuk merr në shqyrtim një material gjuhësor të monitoruar dhe regjistruar në kohë reale, shprehi dhe ligjërimet të kësaj kohe, ai ka ndjekur përvojat dhe analizat në këtë drejtim, sidomos të semiotistëve italianë, si edhe analizon e shqyrton ato copëza ligjërimesh të kësaj kohe, nga këndvështrimi semiotik i sotëm. Në këtë pikëpamje, ndërsa i njohim studimit mangësinë e një monitorimi të dokumentuar të ligjërimin shqiptar të pandemisë, vjelë në kohë reale, i njohim po ashtu përparësinë e analizës së distancuar dhe objektive të atyre ligjërimëve që vijnë nga kjo kohë, nëpërmjet dokumentimit të tyre në rrjetet sociale apo edhe në media, krahasuar me ligjërimin parapandemik dhe atë post pandemik. Në këtë pikë analiza semiotike arrin të përkapë edhe ndryshimin kulturor që solli ky ligjërim pandemik; duke u ndalur vetëdijshëm, tashmë nga distanca kohore dhe duke veçuar natyrën e klasifikimit e këtyre ndryshimeve: të gjuhës në cilësinë e komunikimit të përgjithshëm, gjuhës në marrëdhënie me gjuhët dhe kulturat e tjera, sistemet e tjera të komunikimit. Hedhim pra, vështrimin për të përshkruar semiotikisht këto ndryshime, duke pasur parasysh një referencë, kohën para pandemisë. (Ronchi, 2020)<sup>2</sup>

---

<sup>2</sup> Ronchi, R. (2020, aprile 6 (online)). Teologia del virus. Doppiozero, : *Doppiozero*. Retrieved 27, 2022, from <https://www.doppiozero.com/materiali/teologia-del-virus> “La situazione è strana: da un lato abbiamo la certezza che è in atto un cambiamento radicale, che niente sarà come prima, dall’altro cosa accadrà, quale cambiamento è in corso, resta totalmente indeciso. Il trauma, del resto, ha proprio questa natura. È il sentimento incontrovertibile di un

## Ligjërimi

Si për çdo situatë tipike katastrofe mbarëbotërore, - pandemia është e tillë -, ajo zuri kryet e vendit në komunikimin publik dhe atë privat, duke u bërë ligjërimi mbizotërues i shoqërisë ose, nëse i drejtohem teorive të ligjëritimit, *Ligjërimi me L të madhe*. (Gee, 2018) and (Gee, 2011: 34)<sup>3</sup> Është ky Ligjërim që i lejon asaj, Pandemisë, të ndikojë edhe në mënyrën se si shprehemi, si mendojmë, vlerësojmë, veprojmë dhe ndërveprojmë në kohën e duhur dhe në vendin e duhur dhe me objektet e duhura, për t'u identifikuar si pjesëtarë të një shoqërie (Gee, 2011: 34) në pandemi, dhe ne ishim të tillë, madje edhe në mënyrën se si informoheshim se si informonim. Duke qenë se çdo temë, problematikë e ligjëritimit mbi virusin u ndërthur me një mori variantesh, në kanale të ndryshme informimi, pandemia na tregoi se ai, Ligjërimi, është edhe “pandemik” në rrafshin e informacionit. Ligjërimi pandemik u karakterizua nga shumësia e varianteve dhe copëtimi strukturor, duke transmetuar në këtë copëtim, simptomatik edhe tronditjen shoqërore për ngjarjen mbarëbotërore, pandeminë.

## Komunikimi

Një tjetër çështje që përforcon mendimin për një ndryshim gjuhësor në këtë periudhë pandemie është komunikimi në përgjithësi dhe ai ndërpersonal në veçanti. Komunikimi, shprehja para pandemisë u karakterizua nga lëvizshmëri e vazhdueshme; udhëtimi, rrugëtimi për diku, ecja, vrapi ishin karakteristikë e kësaj lëvizshmërie. Në mjetin e komunikimit më të përdorshëm në këto kohë postmoderne, celularin, pyetja më e zakonshme ishte “*ku je?*”? Sepse kur komunikohet me tjetrin, qoftë edhe për një takim për një kafe, ky ose kjo, do të vinte nga një distancë, ndoshta nga tjetri skaj i qytetit, apo nga një vend tjetër. Në këtë vështrim, ligjërimi postpandemik është i njëjtë, pyetja “*ku je?*” dhe përgjigjia “*erdha!*”, po bëhet sërish normale.

Komunikimi pandemik, përkundrazi nuk karakterizohet nga kjo pyetje. Gjatë pandemisë, nuk ishte e nevojshme të pyesje: “*ku?*” Vendi, ku rrinë apo zhvendosen subjektet të cilëve u drejtohem, nuk kishte më rëndësi. Sidomos gjatë fazës së parë të pandemisë apo edhe më tej, kur vende a grupe të caktuara po i ridrejtoheshin izolimit total apo vetizolimit, për shkak të rritjes së madhe të numrit ditor të të infektuarve apo për shkak të protokolleve të tjera të caktuara për të infektuarit, të qenët në shtëpi u bë detyrë, madje përgjegjësi. Media në përgjithësi dhe Tv publike në veçanti, përforcuan dhe shpërndanë mesazhin e politikës mbarëbotërore ndaj pandemisë, si një strategji përballjeje njerëzore ndaj saj: “*Qëndro në shtëpi, shpëto jetë!*” Prandaj pyetja kryesore në

---

“accadere” che però non ha oggetto.” [Situata është e çuditshme: nga njëra anë jemi të sigurt se po ndodh një ndryshim rrënjësor, se asgjë nuk do të jetë si më parë, nga ana tjetër ajo që do të ndodhë, çfarë ndryshimi po ndodh, mbetet krejtësisht e pavendosur. Trauma, në fund të fundit, ka pikërisht këtë natyrë. Është ndjenja e pakundërshtueshme e një “ndodhie” e cila megjithatë nuk ka asnjë objekt.]

<sup>3</sup> (Gee, *An Introduction to Discourse Analysis, Theory and method*, 2011) “Such socially accepted associations among ways of using language, of thinking, valuing, acting, and interacting, in the “right” places and at the “right” times with the “right” objects (associations that can be used to identify oneself as a member of a socially meaningful group or “social network”), I will refer to as “Discourses,” with a capital “D.” I will reserve the word “discourse,” with a little “d,” to mean language-in-use or stretches of language (like conversations or stories). “Big D” Discourses are always language plus “other stuff.” f. 34.

komunikimet ndërnjerëzore ishte: “*si je?*”/ “*si jeni?*”. Pyetje dhe ligjërim i cili vazhdoi për një kohë të gjatë (me gjithë ndryshimin pozitiv në lidhje me pandeminë) në çdo email të shkruar, në çdo telefonatë të bërë. Shkak i kësaj situatë, kushtëzuese “*Është një kthim në të kaluarën, ne nuk jemi më të interesuar të dimë se ku janë njerëzit, por si janë dhe si janë familjet e tyre.*” (Leone, 2020)

### **Dukja, veshja, pamja, qenia**

Në sfera të tjera të veprimtarisë njerëzore dhe të komunikimit, para pandemisë individi ndiente nevojën e paraqitjes ndaj të tjerëve, *look-u* / dukja, paraqitja, veshja shënonte një aspekt me rëndësi në prezantimin në publik, madje edhe në personalitetin e tij/saj në shoqëri. Vetë veshja si *dukuri thellësisht shoqërore*, edhe pse nga ana tjetër “*...një fakt krejt personal dhe intim që lidhet me shijet dhe dëshirat personale, vlera simbolike e së cilës varet nga ligjet që kapërcejnë sferën individuale.*” (Marrone, 2008: 42-43), në këtë shndërrim të shoqërores në personalen e mbylljes, ka pësuar natyrisht transformimin e saj. Vetë pyetja që mund të karakterizojë këtë sjellje të parapandemisë është “*si dukesh?* / *si duket?* / *si duken?*”. Objekti shenjues i saj është fotografia, imazhi, kapja e atij çasti që e paraqet një shoqëri të *carpe diem*-it, por që përqendron vëmendjen jo në atë që njeriu është, por si duket, si e shohin të tjerët, pra vetja e parë nga jashtë. Kjo do të zhvillohej më pas në një koncept tjetër tek *selfiet*: në “*Si dukemi?*” / “*si dukem?*” me një vështrim nga jashtë në brenda, *si intentio auctoris, intentio lectoris, intentio operis*. (Leone, 2018: 37)

Konceptimi pandemik i pyetjes “*si je?* / *si jeni?*” vjen edhe për pasojë e zhvendosjes së vëmendjes në brenda - jashtë - brenda. Vetë sefiet, të zhvilluara si një model i autoportretit të dikurshëm, (Leone, 2018: 40)<sup>4</sup>, tashmë e kanë zhvendosur vëmendjen tek funksionaliteti apo *intentio operis* e selfies, ata nuk duan të shfaqin, të ndërtojnë personalitetin në publik, (Moreno, 2018: 54) të ndërveprojnë me këtë personalitet, por duan të ilustrojnë përgjigjen e pyetjes “*Si je, Si jeni?*”. Shpesh, si pjesë ilustruese e mesazhit përgjigjës të pyetjes “*Si je, si jeni?*”, selfiet janë mesazhi pamor apo përforcues i tekstit: “*Mirë, po ju?*”. Intertekstualiteti i mesazhit, tekst, zë, foto(selfie), e bën të pashmangshëm kalimin aspektor të pyetjes nga “*Ku...?*” në “*Si...?*”, duke e zhvendosur vëmendjen jo tek vendi, vendet, lëvizja, por tek qenia, njeriu. Për më tepër, selfiet e kohës së koronavirusit, si mesazhi pamor i komunikimit, bashkëshoqërohen, përforcohen edhe nga *maskat*, të cilat duke mbuluar pjesën kryesore më shprehëse të fytyrës: mjekrën, buzët dhe hundën, kanë transformuar procesin e komunikimit edhe subjektin e tyre, të vetëfotografuarin, prandaj edhe lind nevoja të pyesësh, “*si je, si jeni?*”. Veshjes, pamjes së këtij vetëfotografimi, i shtohet një element tjetër i fuqishëm komunikimit pamor: maska.

---

<sup>4</sup> Pas provave anekdotike që ofrojnë sfond biografik për interesin e autorit për selfiet, trajtohet çështja semiotike e kuptimit të tyre, duke bërë dallimin midis kuptimit të marrjes së selfieve dhe kuptimit të selfieve të marra në këtë mënyrë. Të dyja përfshijnë kuptimin auctorial, receptues dhe strukturor, për t'u studiuar në periudhën e gjatë të historisë kulturore të vetë-përfaqësimit dhe në kontekstin e një semiosfere specifike. Selfiet, pra, mund të interpretohen si simptoma të një ideologjie të kohës në zhvillim dhe gjithnjë e më hegjemoniste, në të cilën ikja si nga e kaluara traumatike ashtu edhe nga e ardhmja e mundimshme shkakton një vlerësim të së tashmes duke u shprehur edhe në formatin e ri vizual të selfieve: ata përipiqen të dhurojnë një atmosferë ontologjike parëndësisë së të tashmes postmoderne.

## Maska

Fytyra, siç shtjellon Massimo Leone, në projektin e tij mbi studimin semiotiko-estetik të fytyrës, FACETS<sup>5</sup> (Leone, 2020) merr pamjen e turirit, ndërsa komunikimi joverbal, mbetet të përkapet në morfologji të tjera të fytyrës: sytë, mollëzat, ballin... Vetë selfiet bartin në sfond një mesazh tjetër nga ai i parapandemisë, jo gëzimin, moskokëçarjen, udhëtimin, vendet, qytetet e vizituara, por trishtimin, vetminë, mungesën e komunikimit (fytyra është shndërruar në turi), egërsinë, vdekjen (në rastin e infemireve apo mjekëve të lodhur nga turnet e stërzgjatura). (Leone, 2020)

Për më tepër, përdorimi në masë të gjerë i maskave, llojeve, stileve ka sjellë edhe shumëllojshmëri të tyre. *Në kohën e koronavirusit* nuk mund të flasim në mënyrë të mirëfilltë për modën, shumëllojshmërinë e veshjeve, dukjen, por për një modë të maskës, mund edhe të flasim. Në objektin që shënojnë maskat tashmë e kanë zgjeruar apo ndryshuar kuptimin e tyre, por edhe llojin e përbërjes së tyre.

Për më tepër, në realitetin shqiptar si edhe në shumë vende të tjera tashmë, pas valës së parë të pandemisë maska, paraqitet me variantet e saj funksionalë apo jo: maskë *nën gushë*, që dedukton rrezik të ulët infektimi, apo dalje në mjedis të jashtme, me protokolle më të çliruara. Maskë *nën hundë*, e cila nënkupton një mjedis pune, zyre, një përpjekje për të zbatuar protokollin e sigurisë, por me pak probleme me përshtatjen. Maskë *në krah*, që tregon ndjekjen e protokolleve të sigurisë, (sa për sy e faqe për autoritetet) dhe nga ana tjetër, një lodhje nga ky tjetërsim komunikues. Vetë maska është risemantizuar ashtu si edhe shprehja *me maskë, pa maskë* që buron prej saj. Shprehja *me maskë* është risemantizuar, duke u sendërzuar dhe zgjeruar kuptimin e saj. Sipas *Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe* kuptimi i fjalës maskë është:

MASKË f.

1. Copë kartoni, pëlhure, lëkure etj., e prerë në trajta e përmasa të ndryshme, e vizatuar ose e përkulur në trajtën e një fytyre njeriu a të turirit të ndonjë kafshe, që e vë dikush në fytyrë për të mos u njohur nga të tjerët. *Maskë njeriu. Maskë luani* (tigri, maçoku). *Maskë karnavalesh. Maskë teatri* (cirku). *Ballo me maska. Vuri (hoqi) maskën.*
2. Mbulesë prej lëndësh të posaçme, që vihet në fytyrë zakonisht për t'u mbrojtur nga ndonjë rrezik, nga ndonjë dëmtim etj. *Maskë mbrojtëse. Maskë nënujësë. Maskë garze* (cohe, gome, xhami, teli, metali). *Maskë kirurgu. Maskë saldimi. Maskë skerme. Maskë kundër bletëve. Maskë kundërgaz* (usht.), *Punon me maskë.*
3. Trajtë fytyre prej allçie a prej lënde plastike, që nxirret si kopje e fytyrës së dikujt (zakonisht e një të vdekuri). *Maska e Bethovenit. Maska e të vdekurit.*

---

<sup>5</sup> Face Aesthetics in Contemporary E-Technological Societies (FACETS) është ERC project që studion shembuj bashkëkohorë se si ka evoluar estetika e fytyrës në ndikimin e rëndësishëm të teknologjisë në sjelljen sociale. Projekti FACETS i financuar nga BE-ja në studimin e tij ndërthur historinë vizuale, semiotikën, fenomenologjinë, antropologjinë vizuale dhe studimet e perceptimit të fytyrës në lidhje me njohjen, emocionet dhe veprimet që njerëzit i bashkangjiten ndërveprimit me fytyrat e dikujt a të tjetrit. **Project** FACETS – Face Aesthetics in Contemporary E-Technological Societies; **Researcher (PI)** Massimo LEONE; **Host Institution (HI)** UNIVERSITÀ DEGLI STUDI DI TORINO; **Call Details** Consolidator Grant (CoG), SH5, ERC-2018-COG

4. fig. Pamje e jashtme e shtirë, pamje mashtruese; dukje që fsheh një ndjenjë, një gjendje a thelbin e vërtetë të diçkaje; mbulesë. *Maskë miqësie. Maska e virtytit. Vuri maskën e demokratit (e internacionalistit). Ia grisi (ia çori, ia hoqi) maskën* dikujt a diçkaje, i zbuloi fytyrën e vërtetë dikujt a diçkaje, e nxori në shesh, e demaskoi. *Hoqi (flaku) maskën* doli me fytyrën e vërtetë, e zbuloi plotësisht veten se kush ishte. *I ra maska* i doli fytyra e vërtetë, u zbulua plotësisht kush ishte, u demaskua. (Shkenca.org, 2006-2024)

Në katër kuptimet e fjalës *maskë*, kuptimi i parë dhe i dytë, na intereson në lëvizjen kuptimore apo zgjerimin kuptimor që ka marrë fjala gjatë pandemisë. Ndërsa dy kuptimet e tjera ndalen në maskën e vdekjes dhe kuptimin e figurshëm të saj, kuptime që janë formësuar e motivuar në realje që nuk kanë pësuar ndryshim. Po citojmë nga shpjegimi i kuptimit të parë:

1. Copë kartoni, pëlhure, lëkure etj., e prerë në trajta e përmasa të ndryshme, e vizatuar ose e përkulur në trajtën e një fytyre njeriu a të turirit të ndonjë kafshe, që e vë dikush në fytyrë për të mos u njohur nga të tjerët. *Maskë njeriu. Maskë luani (tigri, maçoku). Maskë karnavalesh. Maskë teatri (cirku). Ballo me maska. Vuri (hoqi) maskën.*

Në dallim nga përkufizimi i mësipërm, lëvizja kuptimore e fjalës *maskë*, përqendrohet tek funksioni i maskës dhe jo tek përbërja, materiali i saj, që paraqitet dytësor në lidhje me përbërësit kuptimorë të fjalës. Në këtë kuptim, ne nuk kemi tashmë përdorimin e maskës *për të mos u njohur nga të tjerët*, por përdorimin e saj, për qëllime mjekësore, për t'u mbrojtur dhe për të mbrojtur. Përdorimi i maskës në masë të gjerë nga popullsia mbarëbotërore, bën që dinamika e shprehjeve gjuhësore me fjalën 'maskë', të pësojë rritje dhe ky ndryshim dhe përgjithësim përdorimi, është thelbi i ndryshimit kuptimor që fjala 'maskë' merr. Pikërisht këtë koncept të maskës si mjet mbrojtës e kemi të shtjelluar në kuptimin e dytë të fjalorit.

2. Mbulesë prej lëndësh të posaçme, që vihet në fytyrë zakonisht për t'u mbrojtur nga ndonjë rrezik, nga ndonjë dëmtim etj. *Maskë mbrojtëse. Maskë nënujësë. Maskë garze (cohe, gome, xhami, teli, metali). Maskë kirurgu. Maskë saldimi. Maskë skerme. Maskë kundër bletëve. Maskë kundërgaz (usht.), Punon me maskë.*

Mirëpo, ky kuptim, ndalet dhe kufizohet në sfera dhe profesione të caktuara në përdorimin e maskës: mjekët (kirurgët), dentistët, zhytësit nënujorë, saldatorët, bletërritësit, ushtarakët... për të cilët identifikohet lloji i maskës, sipas përdorimit: maskë mbrojtëse, mjekësore me nivelin më të lartë të mbrojtjes. Me zgjerimin e sferës së përdorimit mbarëbotëror dhe funksionalitetit të maskës i është shtuar edhe një përbërës kuptimor i maskës, është rigjallëruar kuptimi për materialin përbërës të saj. Maska kirurgjikale mjekësore që përdoret zakonisht në ambiente operative siç janë dhomat e operimit, tashmë ka dalë nga sfera e ngushtë e përdorimit, për t'u bërë e përdorur nga të gjithë. Rrjedhë e kësaj tashmë është pasuar me dikotominë *maskë e blerë, në farmaci, treg dhe maskë e bërë vetë*. Të gjithë e kujtojmë fillimin e pandemisë, kur rrobaqepës lokalë, filluan të përgatisin maska me napë, për t'u gjallëruar pastaj tregu i maskave prej tekstili aq sa edhe në komunikimet për shtyp të Shefes së ISHP-së Albana Fico, datë, 15 tetor 2020, një nga modelet e cilësuar si maskë e detyrueshme është ajo prej tekstili. (Fico, 2020). Për rrjedhë, ka lulëzuar tregu i maskave: çdo shitës ambulant, çdo tregtar i vogël, a i madh (supermarket) ka maska për shitje...të të gjitha llojeve, për nga përbërja, përdorimi, dizajni,

stili, ngjyra. Shtrirja e përdorimit të maskës jo vetëm ka risemantizuar fjalën, por edhe ka gjallëruar shprehjet me fjalën *maskë*. *Me maskë, pa maskë*, (kalon nga kuptimi i figurshëm në atë konkret) *me maskë në krah, me maskë në dorë, me maskë në xhep...* prej këndeje edhe shprehjet frazeologjike: *Ia çori maskën, iu gris maska, i ra maska, e mori maskën, e nxorri maskën, e vuri maskën. Bleu një maskë, hodhi një maskë, uli maskën*, nuk ndërtojnë kuptim në strukturat e thella ligjërimore, por në kuptimin e tyre të parë, bazë. Folësit po iu referohen realiteteve të njëmendëta, dhe maskave konkrete të sendërtuara. Konkretja e maskës, shumësia e veprimeve konkrete që bëhen në këtë periudhë pandemie, dëshmojnë një qasje vigjilente dhe ekzistenciale, si një nga mjetet mbrojtëse ndaj virusit të padukshëm.

Nga ana tjetër, vetë maska, është ngritur në një status të vërtetë ikonik për të simbolizuar pandeminë e koronavirusit, ia vlen të vëzhgohet se si kjo është transformuar me shpejtësi nga një simbol kërcënimi i së padukshmes, një ndotëse e rrezikshme, shenjuese e stigmës së rrezikut, në një gjenerues të një (i sëmurit) ndjenje të anëtarësimit. Pas një periudhe me maska, kur maska u bë normalitet, njeriu nuk kishte më frikë nga ai që vë maskë, por nga ai që nuk e vesh – i cili në rastin më të mirë vihet në dukje si i pavetëdijshëm dhe në rastin më të keq si i shenjuar -, në një qark të shkurtër simbolik që hedh një dritë të keqe jo vetëm mbi idenë pirandeliane, sipas së cilës detyrohem të mbajmë maska për t'u pranuar në shoqëri, por edhe në raportin etimologjik që lidh maskën me *personin*. (Abruzzese & Ragone, 2021: 22)

Maska bëhet kështu një filtër, një membranë kufitare që ndan të pastrën nga e papastra, të shëndoshën nga sëmundja, normalen nga patologjika, rendin nga kaosi, në një përmbysje simbolike të proceseve tradicionale rituale të stigmatizimit dhe etiketimit, ku ajo që më parë ishte shenjë e stigmës, bëhet shenjë e njohjes së sjelljes së mirë të qytetarit të përgjegjshëm. (Abruzzese & Ragone, 2021: 23)

## Shtëpia

Një fjalë/realje tjetër që është rikuptimësuar është fjala “shtëpi”... (ASHSH, 2021) dhe (Promotion, 2013)<sup>6</sup>Sipas fjalorit shpjegues shqip *shtëpi -a: Ndërtesë për të banuar (zakonisht për një familje a për familje të një gjaku); banesë; apartament ku banon një familje. Mirëpo, kuptimisht, pasojë e koronavirusit shtëpi-a, nuk është më ajo e para pandemisë. Shprehjet karakterizuese, sidomos në muajt e parë të pandemisë, riformësuan kuptimin e saj.<sup>7</sup> “Qendro në shtëpi, shpëto jetë!”, ishte shprehja që u shfaq në hashtage e reklama të ndryshme kudo, duke e orientuar konceptin mbi shtëpinë në diç të ngjashme me një kullë ngujimi. (Republika e Kosovës, 2020)<sup>8</sup> Tashmë në shtëpi*

<sup>6</sup> 1. Ndërtesë për të banuar (zakonisht për një familje a për familje të një gjaku); banesë; apartament ku banon një familje. *Shtëpi e madhe* (përdhes, dykatëshe, elbasançe)! *Shtëpia jonë. Shtëpi fshati. Shtëpi me gurë* (me tulla, me qerpiç). *Shtëpi me dy (tre) kate. Shtëpi me avlli. Shtëpi me qira. Një shtëpi këtu, një atje. Oborri kopshti i shtëpisë. Bukë (gjellë) shtëpie. Punët e shtëpisë. I zoti i shtëpisë. Detyra shtëpie detyra që nxënësi i bënë në shtëpi. Ku e ka shtëpinë? Eja nga shtëpia! Rri si në shtëpinë tënde! E mbushi shtëpinë plot me të mira. Shtëpinë shite, shokun mbaje!*

<sup>7</sup> Io resto a casa (It); Stay home, save lives; stay home, stay safe. (br);

<sup>8</sup> **Të gjithë besimtarëve katolik urime Pashkët**

2020/04/11 - 10:36

**Në një urim për për pashkët, thënia përmbyll dhe kurorëzon edhe urimet:**



nuk banohej, por ruhej, ruheshë. *Shtëpia është një imperativ shoqëror dhe një detyrim ligjor: vendi i përgjegjësisë*, - shprehet Anna Maria Lorusso në *Diario Semiotico del Coronavirus*, (Lorusso et al., 2020: 3) duke nënvizuar kështu edhe tjetrin, të tjerët në këtë ruajtje, mbrojtje. Ndihet pra, në këtë shkrim koncepti i ndryshuar për shtëpinë, e cila nga vendi që na përket, (individualja, prona, banesa) është vendi mes publikes dhe individuale. Shtëpia del nga individualja, intima, në publikën. Ajo zhvendoset në hapësirën-kohë të pandemisë nga brenda – në jashtë. Ndërsa kthimi i dhunshëm në shtëpi i individëve që banojnë në të nuk është as edhe kthim në intimitet, por *hapësirë e mbylljes aktive*, (Lorusso et al., 2020: 3) një përmbledhje e asaj që është jashtë në shtëpi, brenda.

*“Me pak fjalë, shtëpitë, banesat, apartamentet nuk janë më private, por publike; kthimi në të cilat nuk është më me vullnet të lirë, një kthim nga puna, nga shkolla, por i detyrueshëm; jo më qetësues, por i përkushtuar ndaj mbrojtjes së shëndetit tonë. Kur do të kthehet shtëpia në vendin që thjesht na pret?”* (Lorusso et al., 2020: 3)

Në fakt, zhvendosja e një sërë punësh për t’u zhvilluar nga shtëpitë, shkollimi, mësimdhënia e kthyen shtëpinë jo vendin që na përket, vendin e privates, intimitetit, por në një vend pune-jetese, në gjithë shumëkuptimësinë që kjo fjalë kompozitë sugjeron. Aq shumëdimensional bëhet koncepti mbi shtëpinë tek njeriu sa agjensitë imobiliare në Itali raportojnë se pandemia ka ndryshuar edhe konceptin e klientëve për të zënë shtëpi me qera apo për të blerë shtëpi. Njerëzit kanë filluar të kuptojnë se shtëpia parakovidiane nuk i zë gjithë këto veprimtari të jetës së njeriut: shtëpi-shkollë, shtëpi-punë, shtëpi-zyrë. Sipas Sondaggio Arexons: *come è cambiata la percezione della casa nel II lockdown*, (Perolari, 2021: 78), dhe Alessandro D’Orlando, psikoterapeut i platformës on line të Top Doctors, që zgjedh dhe vë në dispozicion të përdoruesve një panel të përbërë nga specialistët më të mirë mjekësorë nga e gjithë bota, i cili komenton mbi të dhënat e mbledhura nga sondazhi në këto rreshta:

*“Shtëpia përfaqëson shtrirjen e egos dhe të kesh një shtëpi të pastër dhe të rregullt është e rëndësishme për ruajtjen e vetëvlerësimit, ndjenjës së kontrollit mbi mjedisin përreth dhe sigurisë. Në të njëjtën kohë, të gjithë duhet të punojmë për të zbuluar këtë ndjenjë të 'shtëpisë' brenda nesh përmes praktikave, të tilla si meditimi, të cilat na ndihmojnë të ndihemi mirë thjesht duke mbyllur sytë dhe duke përqendruar mendjen. Në këtë mënyrë mund të ndiheshim mirë kudo, edhe jashtë shtëpisë dhe madje edhe në vende që më parë na trembnin”* (Come è cambiata la percezione della nostra casa ai tempi del secondo lockdown? , 2020).

Shtëpia, po t’i referohemi Piramidës së Abraham Maslow-t (Maslow, 2017) plotëson nevojat psikologjike, të njeriut, ajo është strehë nga moti i keq, vend pushimi dhe strehimi..., ajo plotëson nevojat që lidhen me sigurinë, është vend mburojë ndaj kërcënimit të natyrës fizike apo strehë ku kurohemi nga sëmundje (karantina, për shembull), vend ku gjejmë mbrojtje të natyrës

---

**“Komuna e Kamenicës i uron të gjithë besimtarëve katolik pashkët.**

Ju urojmë paqe, shëndet, bekim dhe mbarësi.

Të qëndrojmë në shtëpi dhe të lutemi që sa më shpejt të kaloj kjo situatë, që ti kthehemi normalitetit.

Qëndro në shtëpi, shpëto jetë.”

psikologjike, prandaj lartohet në përmasat e funksionalitetin e një kështjelle apo të një kulle ngujimi në kohën e pandemisë. Ky ishte këndvështrimi, vlera e shtëpisë parë nga jashtë.

Në qasjen e shtëpisë nga vetë ne si banues, ajo bart e plotëson nevojat tona për përkatësi dhe dashuri: *është shtëpia e babës, shtëpia e prindërve, shtëpia jonë, shtëpia e marrë me qera, apartamenti, dhoma e hotelit ku po qëndrojmë për pak kohë*. Këtyre u është shtuar, *shtëpi e karantinuar, krahas shtëpi e izoluar* dhe kur është e tillë ajo merr vlerën e të veçuarës dhe të shenjtarës, është si maska që në njërin anë mbron mbajtësin nga të tjerët, të hipotezuarit pozitivë, apo nga virusi vetë i padukshëm. Shtëpia, mbron edhe dhe mbrohet.

Po shtëpia i përgjigjet nevojës për vetëvlerësim, e mobiluar në brendësi, me orendi që ofrojnë lehtësi dhe kënaqësi, ajo përfaqëson kështu vendin që zëmë në hierarkinë shoqërore. Këtu koncepti i shtëpisë përkon me atë të një skene, që pasqyron suksesin e atij që banon në të, parë nga syri i tij apo i të tjerëve jashtë. Gjatë kohës së pandemisë, këtij sukcesi, kësaj hierarkie vlerash shoqërore iu vu re një mungesë funksionaliteti. Sepse nuk mjaftonte komoditeti brenda, shtëpia lipsej këtë rradhë të përballonte edhe një shtëpi-zyrë, vend pune, shtëpi-klasë, dhe duke u shndërruar në koncept, u copëzua në funksionalitet.

## **Virusi, njeriu**

Vetë fjala virus, del nga përdorimi i ngushtë mjekësor për të hyrë në sferën e shoqërores, për të shprehur qëndrim, vlerësim, duke zgjeruar sferën e kuptimeve që ndërton në ligjërime të ndryshme: *ramavirus* (KohaJonë, 2020), *virusimi i gjuhës* shkruan Sh. Dodda (Dodda, 2020), *virusi i korrupsionit* (News, 2022), *virusi i shoqërisë, virusi i anarkisë*, etj...Ashtu siç natyrisht janë aktivizuar fjalë e shprehje që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me pandeminë si: *vetëizolim, vetëkarantinim, lockdown*, (përballë shtettrrethim), *distancim social*, ashtu si me këtë për rrjedhojë u shfaqën fjalë *zooming, on line meeting, videokonferencë, konferencë hibride, platformë, google classroom, mësim në distancë*, apo *on line* etj (Abdel-Raheem, 2021: 525)

## **"... në kohën e koronavirusit"**

Sidomos shprehja *"... në kohën e koronavirusit"* (ose Covid-19, ose pandemia) terma që konsiderohen ekuivalentë, ka gjetur vend në mënyrën e të menduarit të gjithësecilit. Ky term, i kombinuar me lëndë të ndryshme, ka hyrë në përdorim për të ripërcaktuar të gjitha llojet e aktiviteteve, individuale dhe kolektive, të cilat u transformuan/ shformuan në periudhën e pandemisë dhe për këtë kishin nevojë që të kishin si cilësor pandeminë ose covid-19 apo koronavirusin. Aspektet e shebullëzuara i ndeshim tek: *ecje në kohën e koronavirusit, vrapimi rreth bllokut të pallateve...*, *xhiro me biçikletë në kohën e koronavirusit, miqësi në kohën e koronavirusit* (komunikimet në internet dhe dërgimi i fotove dhe videove në chat), *mbrëmje në pandemi*, (doli virtuale mes miqsh të mbledhur në një platformë online), *Pashkët e koronavirusit, Bajrami i koronavirusit, takime në pandemi/në kohën e koronavirusit* (miqësi e kujdesshme në distancë në uebfaqe), *psikoterapi në kohën e koronavirusit* (reflektime në seanca përmes telefonit dhe në internet), *provime në kohën e koronavirusit, matura e koronavirusit* etj.

## Një tjetër shprehje...

Shprehja e referuar dhe e shpërndarë në shtyp dhe në internet, ka pasur përhapjen tipike të komunikimit masiv që nga fillimi i pandemisë: e shpejtë, tërthore dhe virale; ajo është bërë kaq shpejt një ligjërim i ri konvencional, që vazhdon të jetë i kuptueshëm edhe pasi ka mbaruar pandemia. Kjo vjen ngaqë segmenti kohor që shenjon ... *në kohën e koronavirusit*, është i veçuar dhe i mbushur me kuptim dhe ngjarje, domethënëse për të gjithë folësit.

Funksioni më i dukshëm i shprehjes "*... në kohën e koronavirusit*" është ai njohës, pasi zbatohet në përpjekjen për të përshkruar, analizuar, kuptuar ndryshimet e shkaktuara nga pandemia në sjelljet dhe stilin e jetës. Në një krizë e përgjithshme, siç ishte koha e pandemisë, proceset njohëse synojnë të rrisin aftësinë e gjithpërfshirjes e të jenë elastikë dhe evokues. Komunikimi kolektiv mundëson shtrirjen përtej sferës individuale. Por meqenëse "*... në kohën e ...*" është një term mjaft i vjetëruar dhe stereotip, përsëritja e tij, në kapërcime kuptimore krijon formulime të reja po aq sinkretike, më të larmishme dhe të pasura me përmbajtje. Vetë fakti që sot mund të identifikojmë si filma të pandemisë, libra të pandemisë, ato filma edhe ato libra, që kanë pasur si tematikë të veçantë si: fundin e botës, murtajën, viruset, dhe që na bashkëshoqëruan apo i përzgjedhëm si të tillë gjatë kësaj periudhe, tregojnë nga njëra anë se si njerëzit përpiqen të pranojnë fatin e tyre në pandemi, si edhe shumësinë e kuptimeve që vetë shprehja e mësipërme "*...në kohën e koronavirusit*" shenjon për shoqërinë.

Prej këndeje, elementi më domethënës i suksesit të një shprehjeje gjuhësore është ndoshta ai që shkon përtej nivelit përshkruar dhe informues, duke shkaktuar formimin e një imazhi me konotacione të shumëfishta në kohë. Kjo zhvillohet përmes ndërtimit "*... në kohën e ...*", në të cilën koha, veprimi i qartë ose i nënkuptuar, shënon/ asocion një kohë të kaluar, si në shprehje të tilla si: "*në kohën e Noes*", "*n'kohë t'Nuhut*", "*në kohën kur...*", "*në kohën e kohës*", "*në kohën e xhaxhit*", "*në kohën e Babaqemos*" dhe të ngjashme. Pikërisht këtu shprehja fiton vertikalisht edhe pse buron prej konkretes. Rezultati psikologjikisht i rëndësishëm për lexuesin është ai i vendosjes së pandemisë në të kaluarën dhe tani me kalimin e kohës, duke e zhytur në kohë e duke e metaforizuar, kthimi i saj në kohë të rrëfyer: *duket se "e gjithë kjo ndodhi ... në kohën e koronavirusit"*. Kështu ajo mund të ripërkufizohet si një pandemi e rrëfyer, e cila "njëherë e një kohë" komunikohet si imazhi i një pandemie shtresuar në kujtesat e rrëfyer nga një e ardhme e të mbijetuarve.

Duke pasur parasysh se shprehja është bërë pjesë e ligjëritit pandemik, që në kulmin e saj, analiza e saj, në kontekstin e një krize ekzistenciale njerëzore, zbulon jo vetëm vlerën e një funksioni përshkruar ose shpjegues, rrëfyes, deri diku edhe dëshmues, por edhe atë të një veprimi komunikues të aftë të ndikojë në realitetin, ta përthyejë atë. Meqenëse mohimi i pandemisë e koronavirusit kërcënon ekzistencën njerëzore dhe në të njëjtën kohë përhapet një rrjedhë e pakontrollueshme informacioni shpesh kontradiktore, i cili, në vend që të sigurojë, rrit ankthin dhe vë në dyshim edhe mjetet e shkencës dhe teknologjisë, psikika e njeriut rrezikon të humbasë në një kaos kryengritës. (Ferraro, 2021) Përballë këtij kërcënimi, qenia njerëzore përpriqet të ndërtojë

rrugë shpëtimi përmes formave të ndryshme mbrojtëse në dispozicion të tij; rrëfimi është një nga proceset themelore që ndërhyjnë për të rikthyer kuptimin në përvojën e ngjarjeve që, nëse nuk do të ishin, do të rrezikonin të shfaqeshin si një seri e pakuptimtë dhe për të rikthyer rendin në botën e brendshme të njerëzve. Shprehja, si segment aspektor i kohës, ka një vlerë terapeutike, të njohur përgjithësisht në kontekstin e kujdesit të ashtuquajtur, por që ekziston mbi të gjitha në marrëdhënie spontane dhe natyrore: siç thotë Hillman (1983: 56), mendja bazohet në aftësinë e saj narrative.

## **Përfundime**

Pandemia e COVID-19 ka sjellë ndryshime thelbësore në shoqëri, duke transformuar koncepte të njohura dhe imponuar nevojën për reinteretim të tyre. Maska është shndërruar në një simbol të përgjegjësive qytetare dhe solidaritetit ndaj të tjerëve, ka ndryshuar kuptimin e saj tradicional në gojën e folësve dhe është bërë një simbol të sjelljes së mirë të qytetarëve të përgjegjshëm. Shtëpia është transformuar nga një hapësirë private në një vend ku kryejmë shumë nga aktivitetet tona publike dhe profesionale, duke ndryshuar perceptimin dhe përdorimin e saj në jetën tonë të përditshme. Pandemia ka krijuar një gjuhë të re dhe një mënyrë të re të përshkrimi të realitetit, duke e bërë fjalën "virus" një simbol të përgjithshëm për çdo fenomen të rrezikshëm në shoqëri dhe duke shkaktuar lëvizje gjuhësore. Shprehja e zakonshme "... në kohën e koronavirusit" ka ndihmuar në shkëmbimin e përvojave dhe kuptimeve gjatë kësaj periudhe, ajo reflekton ndryshimet thelbësore në mënyrën tonë të menduarit dhe të shprehurit.

## Literatura:

- Abdel-Raheem, A. (2021, September). Reality bites: How the pandemic has begun to shape the way we, metaphorically, see the world. *Discourse & Society*, 32(5), 519-541. doi:10.1177/09579265211013118
- Abruzzese, A., & Ragone, G. (2021). *Shockdown: Media, cultura, comunicazione e ricerca nella pandemia* (Vëll. e 9, NAUTILUS). Milano: Meltemi.
- ASHSH. (2021, 3 4). *Kuptimi i fjalës shtëpi*. Gjetur 3 2, 2021, nga Fjalor i Gjuhës Shqipe: [www.fjalorthi.com](http://www.fjalorthi.com)
- Come è cambiata la percezione della nostra casa ai tempi del secondo lockdown?* . (2020, 12 20). Gjetur 2 5, 2022, nga Medicina e Informazione Web Tv <https://www.medicinaeinformazione.com/>: <https://www.medicinaeinformazione.com/news/come-e-cambiata-la-percezione-della-nostra-casa-ai-tempi-del-secondo-lockdown>
- Dodda, S. (2020, 4 15). *Virusimi i gjuhës*. Gjetur 4 15, 2020, nga MEXHLIS.COM: <https://mexhlis.com>
- Ferraro, G. (2021, Mars 4). L'accidente e il sistema. Forme di narrazione dell'epidemia. *Acta Semiotica*, 104–124. doi:<https://doi.org/10.23925/2763-700X.2021n1.54160>
- Fico, A. (2020, Tetor 15). Nga data 15 tetor 2020 maska ose barriera mbrojtëse prej tekstili bëhet e detyrueshme kudo jashtë .. Tiranë, Albania, Albania. Gjetur në <https://www.youtube.com/watch?v=WZwPWBXgQAI>
- Fossali, P. B., & Dondero, M. G. (2006). *Semiotica della fotografia, Investigazioni teoriche e pratiche d'analisi con due saggi di H.Shairi/J. Fontanille e A. Beyaert*. Rimini: Guaraldi.
- Gee, J. P. (2011). *An Introduction to Discourse Analysis, Theory and method* (bot. i Third edition). New York & London: Routledge.
- Gee, J. P. (2018). *Hyrje në analizën e ligjërrimit teori dhe metodë* (bot. i 3). (G. A. Egro, & B. Smajli, Përkth.) Tiranë: UET Press.
- Hillman, J. (1983). *Archetypal Psychology: A Brief Account* (bot. i III). New York: Spring Publication Inc.
- KohaJonë. (2020, 5 20). *Parrullat e artistëve: “Ramavirus”, “Protesta ta fik llullën”*”, on line. Gjetur 2 15, 2022, nga Koha Jonë web site: <https://kohajone.com/parrullat-ne-proteste-ta-fik-llullen/>
- Lakoff, G., & Johnson, M. (1980). *Metaphors We Live By*. Chicago: University of Chicago Press.,
- Leone, M. (2018, 4:2 December). Semiotics of the Selfie: The glorification of the present. (G. Paschalidis, Re.) *Punctum. International journal of semiotics, Special issue on Semiotics of Selfies*, 33-48.

- Leone, M. (2020, Aprile 8). I volti del Coronavirus, semiotica di una pandemia. *Unito News* . (U. News, Intervistuesi) [https://www.unitonews.it/index.php/it/news\\_detail/i-mille-volti-del-coronavirus-semiotica-di-una-pandemia](https://www.unitonews.it/index.php/it/news_detail/i-mille-volti-del-coronavirus-semiotica-di-una-pandemia). Torino. Gjetur ottobre 30, 2021, nga [https://www.unitonews.it/index.php/it/news\\_detail/i-mille-volti-del-coronavirus-semiotica-di-una-pandemia](https://www.unitonews.it/index.php/it/news_detail/i-mille-volti-del-coronavirus-semiotica-di-una-pandemia)
- Lorusso, Anna Maria; Marrone, Gianfranco; Jacoviello, Stefano. (2020). *Diario semiotico sul Coronavirus*. Palermo, Italia: EIC. Gjetur në [www.ec-aiss.it](http://www.ec-aiss.it)
- Marrone, G. (2008). *Trupat shoqërorë; proceset komunikuese dhe semiotika e tekstit*. (D. Shehri, & P. Asllani, Përkth.) Tiranë: Dudaj.
- Maslow, A. H. (2017). *A Theory of Human Motivation*. New York: Dancing Unicorn Books.
- Moreno, S. (2018). Selfie-taking: a key semiotic practice within the ‘show of the self’. *Punctum*, : 49-65, 2018, 4((2)), 49-65.
- News, A. (2022, 2 1). Vëzhguesi i famshëm i ONM-së Theo Jacobs/ përveç virusit të korrupsionit e ka kapur dhe Covid 19. *www.in-front.org*. Gjetur 2 10, 2022, nga <https://in-front.org/vezhguesi-i-famshem-i-onm-se-theo-jacobs-pervec-virusit-te-korrupsionit-e-ka-kapur-dhe-covid-19/>
- Perolari, C. (2021, gennaio/febbraio). Sondaggio Arexons: come è cambiata la percezione della casa nel II lockdown. *Ferrutensil: Il magazine per l'utensileria e la ferramenta specializzata*.(1), f. 78. Gjetur në [www.ferrutensil.com/rivista](http://www.ferrutensil.com/rivista)
- Promotion, C. f. (2013). Albanian Explanatory Dictionary - AED 1.0. *Shtëpi*. Gjetur në [www.gjuha-shqipe.com](http://www.gjuha-shqipe.com)
- Republika e Kosovës, K. (2020, 4 11). *Republika e Kosovës, Kamenicë*. Gjetur 9 10, 2021, nga <https://kk.rks-gov.net/>: <https://kk.rks-gov.net/kamenice/news/te-gjithe-besimtareve-katolik-urime-pashket/>
- Ronchi, R. (2020, aprile 6 (online)). Teologia del virus. Doppiozero, .: *Doppiozero*. Gjetur 2 7, 2022, nga <https://www.doppiozero.com/materiali/teologia-del-virus>
- Senaldi, M. (2021). *Pensare oltre. Come la riflessione filosofica può aiutarci nell'epoca della pandemia*. Milano: Piemme.
- Shkenca.org. (2006-2024). *FJALOR I GJUHËS SË SOTME SHQIPE*. Shkenca.org. Gjetur 4 5, 2024, nga <http://www.fjalori.shkenca.org/>